



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 , Strategjisë dhe Planit të veprimit për përfshirjen e komiteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare (2017-2021) dhe neneve 9, 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL VEPRUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim themelohet Komisioni komunal veprues në përbërje si vijon:

1. Fauz Xhemajli, Nënkryetar i Komunës, Kryesues
2. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, anëtar
3. Vlora Limani, Drejtoreshë e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtare
4. Emina Rexhiq, Drejtoreshë e Drejtoratit për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
5. Radmila Simijanovic, Shefe e Zyrës Lokale për Komunitete
6. Gjyste Dabaj, Kordinatore e NJDNJ dhe barazi gjinore
7. Shaban Sylja, Shef i Sektorit për Buxhet dhe Financa
8. Florim Bajrami, Voice of Roma, Ashkali and Egyptyan, (organizatë ndërkombëtare) anëtar
9. Dhurata Prokshi , Balkan Sunflowers Volunteers for Social Reconstruction, (organizatë ndërkombëtare), anëtare
10. Bajram Ademi OJQ "Krahë Hapur", (OJQ vendore), anëtar
11. Jakup Haliti OJQ "Zemra e Hapur" (OJQ vendore), anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit komunal veprues

1.Komisioni do të bëjë monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të veprimit për përfshirjen e komiteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare (2017-2021). Përveq monitorimit ky Komision do të shërbejë edhe si strukturë mbështetëse lokale për kordinimin e aktiviteteve me Zyrën e Kryeministrit/Zyra për qeverisje të mirë në kuadër të procesit të zbatimit të strategjisë.

2. Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit ka paraparë detyrat dhe përgjegjësitë specifike në kuadër të zbatimit dhe monitorimit të strategjisë për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë , për Pikat e Kontaktit , si dhe për Komunitete Komunale Vepruese në nivelin lokal.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit Komunal Veprues.

1Nr. 020 - 15204

Lipjan, më 12.03.2018

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

